



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 67/12
Prishtinë, më 28.05.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303.

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante), Dafina Krasniqi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ismet Krasniqi Sekretar i Kuvendit, Betim Gjoshi, Florian Dushi nga KQZ, Binak Vishaj, Miradije Meha nga KQZ, Edi Shukriu dhe Hilmi Demolli nga KKTK.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur e komisionit dt. 16.05.2012 dhe 23.05.2012;**
3. **Shqyrtimi i Kërkesës për Rishikim të Buxhetit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012;**
4. **Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011;**
5. **Shqyrtimi i Raportit Financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011;**
6. **Shqyrtimi Propozim-Vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimitisht.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur e komisionit dt.16.05.2012 dhe 23.05.2012

Kryetarja, konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Kërkesës për Rishikim të Buxhetit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012

Kryetarja, theksoi se kërkesa e Kuvendit ka të bëjë me lëvizje brenda buxhetit apo transfere të brendshme, por njëkohësisht është edhe një kërkesë për shtim të mjeteve. Është një kërkesë shtesë për Paga dhe Mëditje, në programin Administratës së Kuvendit, si dhe investime kapitale, po ashtu është kërkuar mjete shtesë për stafin mbështetës politik. Duhet t'i kemi parasysh që kërkohen mjete shtesë dhe jo gjithmonë është e lehtë të realizohen kërkesat për mjete shtesë.

Ismet Krasniqi, me rastin e shqyrtimit të buxhetit për vitin 2012, janë lejuar vende të punës në administratën e Kuvendit por nuk janë paraparë kompenzime për pagat e tyre, prandaj edhe është kërkuar mjete shtesë. Të stafi mbështetës politik është një shumë që ka mbetur e hapur nga fillimi i vitit buxhetor. Kemi kërkesën nga partneret ndërkombëtar që e mbështesin Kuvendin por edhe nga disa deputet që të kemi shtatë zyre që në qendrat rajonale, dhe nëse komuna i siguron objektet, si Kuvend do të paguajmë vetëm asistentet për këto zyre dhe furnizimin më pajisje. Kërkesa për mallra dhe shërbime në programin për deputetët ka të bëjë me blerjen e laptopëve për 36 deputet që në muajin maj kanë bërë 4 vite që i kanë shfrytëzuar laptopët nga legjislatura e kaluar. Për investimet kapitale janë specifikuar projektet që janë nevoja të domosdoshme për mjete shtesë.

Sali Asllani, sa i përket kërkesës për paga dhe mëditje, do të duhej të ishte dikush nga Ministria e Financave që të jep sqarime, kur dihen kufizimet me marrëveshjen e FMN-së. Sa i përket zyreve për deputetë, mendojë se nuk do të ishin funksionale, deputetë e të gjitha komunave nuk do të shkonin në zyrën e qendrës rajonale, dhe ne kemi nevojë parasegjithash që të bëhet një zgjidhje e zyreve për deputetë në Kuvend dhe kjo duhet të jetë prioritet.

Hykmete Bajrami, do të dëshiroja që kërkesat të mos vijnë vetëm nga administrata, por kryesisht nga deputetët, dmth të tregojnë deputetet se cilat janë ato mangësi që i kemi ne në aspektin administrativ që nuk po na lënë më kryejmë punët siç duhet, siç është rasti i mungesës së zyreve. Sa i përket pagave nëse janë për stafin ekzistues duhet të behët zgjidhje, sepse nuk mund të i largojmë njerëzit nga puna. Sa i përket shtatë qendrave rajonale, kjo kish më qenë zgjidhje e mirë, por se prioriteti është që më pas një zyre në Prishtinë edhe hapja e zyrave në qendrat rajonale do të duhej të jetë e lidhur me reformën zgjedhore, për të parë krijimin e zonave zgjedhore.

Muhamet Mustafa, rekomandimi i parë është që mundësisht shërbimi financiar i Kuvendit të bëjë rirregullimin apo ristrukturimin e brendshëm të buxhetit, duke iu dhënë prioritet shpenzimeve. Rekomandimi tjetër është që zyret rajonale nuk janë të arsyeshme, nuk janë funksionale, nëse ka nevojë atëherë duhet në çdo komunë të bëhen zyret. Ndërkaq kërkesat për paga dhe mëditje për punëtorët do të duhej pranuar, pasi që nuk mund të lëmë njerëzit pa paga.

Xhevdet Neziraj, do të duhej të mbështesim Kuvendi, që të jetë funksional, mirëpo duke ditur që kemi të bëjmë me rishikim të buxhetit, të shikohet qfarë mund të kursehet brenda buxhetit në bazë të prioritetëve të shpenzimeve. Sa i përket zyreve regjionale është një projekt që ka funksionuar edhe në të kaluarën në mbështetjen të organizata e huaja dhe nëse ka mundësi pse mos më funksionalizue. Po ashtu mbështes mendimet që nëse njerëzit që janë duke punuar mos t'i lëmë pa paga.

Kryetarja, realisht unë nuk e kam kërkesën shtesë që paraqiti sekretari tani, dhe të paktën anëtarët e Komisionit për Buxhet është dashur të kemi më të detalizuar dhe arsyetuar kërkesat dhe të shohim sa është vërtetë kërkesa reale për mjete shtesë, pasi që dijmë se edhe me raportin e progresit jemi kritikuar për buxhetin e Kuvendit. Sa i përket kërkesës për zyret regjionale, do të ishte mirë të shikohet që Kuvendi në bashkëpunim me partnerët që mbështesin Kuvendin, që në formë të bashkëfinancimit të mundësohet hapja e këtyre zyreve dhe të bëhet një zgjidhje efektive e këtij problemi. Unë jam iniciatore që këto zyre të jenë funksionale se kam bërë përpjekje vete më hap zyre të tillë. Sikur të ish analizu mirë buxheti për mallra dhe shërbime, laptopët ishin blerë vitin e kaluar kur iu janë blere deputetëve tjerë.

Latif Gashi, gjatë shqyrtimit të buxhetit të Kuvendit, realisht kemi bërë shkurtime për paga dhe mëditje, projekte kapitale edhe për tjerat. Për zyret regjionale është një shumë e vogël 40.000 mijë euro nuk kemi nevojë më i politizue. Unë rekomandojë të kemi materialin e kompletuar, së bashku me kërkesat shtesë, dhe të shqyrtojmë mëpastaj në Komision.

Ismet Krasniqi, kërkesa shtesë ka të bëjnë me 36 mijë euro për blerjen e Laptopave dhe 41 mijë për zyret regjionale. Tek pagat raporti i progresit ka shënuar mungesë të ekspertëve për deputetë. Vitin e kaluar kemi fituar 10 vende të punës që janë lejuar, 6 zyrtarë në njësinë për hulumtime dhe 3 zyrtarë në zyrën e sekretarit dhe një zyrtarë për kontakt me shoqërinë civile. Kjo është njësia hulumtuese dhe kemi mandej staf mbështetës për komisionin. Një kërkesë 4 mijë euro do të jetë për një veturë.

Sali Asllanaj, parimisht e përkrah edhe kërkesën më kusht që të mos jetë konflikt më një marrëveshje që kemi me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që se paku që mos të akuzohemi që e prishim marrëveshjen. Nuk mund të jetë një asistent që do të punonte për stafin politik të partive të ndryshme në zyret regjionale, do të jetë jofunksionale.

Hykmete Bajrami, sa i përket kërkesës për themelimin e njësisë hulumtuese kjo ka qenë si kërkesë e deputetëve dhe plotësisht e përkrah dhe kjo është më se e nevojshme për efikasitetin e Kuvendit, dhe nëse kemi një mbështetje të tillë të paktën ne si komision, mundemi më i kursye buxhetit të Kosovës qindra mijëra euro ndoshta edhe miliona. Mirëpo ne si deputet duhet me i pas kërkesat e qarta se çka presim prej njësisë hulumtuese dhe përshkrimi i qartë i detyrave të punonjësve të kësaj njësie.

Latif Gashi, lidhur me kërkesën për mjete shtesë për paga dhe mëditje, është mjaft e lartë dhe unë jam dakort për arsye se vitin e kaluar ju kemi shkurtuar buxhetin, mirëpo nuk jam në dijeni nëse keni pas ndonjë takim me ministrin e financave dhe nëse jeni dakorduar për këto mjete shtesë?

Kryetarja, unë e përkrah kërkesën për stafin e administratës për paga dhe mëditje mirëpo kam vërejtje për mënyrë se si është paraqitur kërkesa sepse ka mangësi në të dhëna. Problemi është çështja e mundësisë së futjes në buxhet me këto kufizime që i kemi ne me FMN-në. Përfaqësuesit e FMN-së janë në Kosovë, prandaj restriksionet që vijnë duhet t'i kemi parasysh.

Jelena Bontic, pyeti se në cilat rajone është planifikuar të hapen zyret rajonale?

Kërkesa për mallra dhe shërbime në programin deputetët e Kuvendit miratohet dhe me katër vota Për (Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Latif Gashi dhe Sali Asllanaj) me një votë Kundër (Muhamet Mustafa), tre vota Abstenim (Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Hasime Krasniqi).

Kërkesat për paga dhe mëditje dhe investime kapitale në programin administrata e Kuvendit, përkrahen Njëzëri. Po ashtu njëzëri përkrahen kërkesat për transfere të brendshme, ndërkaq njëzëri nuk përkrahet

kërkesa për mjete shtesë për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime në programin stafi mbështetës politik.

Pas diskutimeve, Komisioni për Kryesinë e Kuvendit nxori këtë

REKOMANDIM

I. Të miratohen kërkesat Kuvendit të Kosovës për mjete shtesë në rishikim të buxhetit për vitin 2012, në vlerë prej 226,600 €, si në vijim:

1. Programi Deputetët e Kuvendit
 - Mallra dhe Shërbime, në vlerë prej 36,000 €
2. Programi – Administrata e Kuvendit
 - Paga dhe Mëditje, në vlerë prej 106,600 €.
 - Investime Kapitale, në vlerë prej 84,000 €, për projektet si në vijim:
 - Renovimi i aneksit, në vlerë prej 50,000 €
 - Modernizimi dhe paisja me teknologji digjitale të sallave konferenciale dhe sallës plenare , në vlerë prej 30,000 €
 - Automjete për nevoja të Kuvendit, në vlerë prej 4,000 €.

II. Të miratohet kërkesat e Kuvendit të Kosovës për transferet e brendshme buxhetore në rishikim të buxhetit për vitin 2012, në vlerë prej 43,000 €, si në vijim:

1. Programi – Administrata e Kuvendit
 - Transferi nga kategoria ekonomike shpenzime komunale në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në vlerë prej 40,000€
 - Transferi brenda kategorisë ekonomike projektet kapitale, nga projekti kapital “Shkallët kundër zjarrit”, shuma prej 3,000€, transferohet në projektin kapital “Ndërimi i liftit hidraulik në atë elektrik te hyrja kryesore”.

III. Komisioni nuk përkrahu kërkesat shtesë të Kuvendit të Kosovës për rishikimin e buxhetit për vitin 2012, në vlerë prej 49,020 €, si në vijim:

1. Programi Stafi Mbështetës Politik
 - Paga dhe Mëditje, në vlerë prej 41,020 €
 - Mallra dhe Shërbime, në vlerë prej 8,000 €

4. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për vitin 2011

Kryetarja, shkurtimisht përmendi bazën ligjore për raportim të KQZ dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike, bazuar në raportin e KQZ për vitin 2011.

Betim Gjoshi, theksoi se për shkak të zgjedhjeve në fund të vitit 2010, një pjesë e madhe e shpenzimeve, janë bartur në vitin 2011, si dhe shpenzimet me përseritje në 4 komuna. Pjesa e buxhetit që ka mbetur ka të bëjë me fondin për mbështetje të partive politike që nuk është alokuar në dyfishin e asaj që ka qenë e nevojshme për shpenzim dhe figuron si mbetje, sepse dihet që 0.17% e buxhetit ka qenë mundësia maximale për tu shpenzuar, ndërsa në kemi pasur 0.35% të alokuara dhe ka ndikuar që të kemi një suficit më të lartë.

Shumica e shpenzimeve, janë për komisioner të këshillave të votimit 330 mijë euro, pastaj stafi i angazhuar në qendrën e numërimit të rezultateve.

Latif Gashi, vlerësoi se raporti në përgjithësi është i mirë. Përfshinë të hyrat, shpenzimet, grantet me përjashtim tek nënkategoritë ekonomike ka një mosplanifikim të mirë. Keni deklaruar shpenzimet e qirasë rreth 72 mijë euro, a keni bërë përpjekje të gjeni një lokacion tjetër që t'i zvogëloni këto shpenzime?

Xhevdet Neziraj, sa i përkt financimit të subjekteve politike, edhe para këtij takimi kam cekur se ka keqinformime në media, ku po flitet partive politike po iu ndahen mjete bazuar në përqindjen 0.34, e që në fakt ndarje e mjeteve për financimin e subjekteve politike është bërë duke u bazuar në përqindjen 0.17 dhe kjo është mirë të sqarohet, si ka ndodhur realisht financimi i partive politike. Sa i përket shpenzimeve është pak shqetësuese realizimi i ulët i buxhetit prej 60% dhe në pikëpamje ekonomike shihet mosplanifikimi i mirë, ndoshta edhe për shkak të specifikave të këtij institucioni, por besoj që në të ardhmen të jetë një planifikim më i mirë i buxhetit.

Kryetarja, ajo qfarë planifikohet me buxhet është mirë të reflektoj në efikasitet në punë. Kemi shërbimet e kontraktuara 884 mijë euro është mirë të njoftohemi se për çfarë është fjala këtu? Meqenëse po diskutohet shumë në media a po raportojnë partitë politike tek KQZ sipas ligjit?

Betim Gjoshi, mosshpenzimi i buxhetit. ka të bëjë që Ministria e Financave ka alokuar buxhet për financimin e partive politike dyfish më shumë se sa ka qenë nevoja dhe kjo nuk ka të bëjë me planifikimin e KQZ-së, por ka të bëjë me grantet që KQZ ua jep partive politike dhe na ngarkuar mjete rreth 5 milion euro që sipas ligjit nuk kemi pasur mundësi t'i shfrytëzojmë më shumë se 0.17%. Ka qenë një gabim i tyre i kemi njoftuar me kohë por nuk kanë mundur të tërhiqen dhe kanë mbetur si të tilla në pasqyrat tona financiare pa faj tonin sepse ne nuk jemi pyetur kur janë alokuar ato. Sa i përket pjesës së mbetjeve të teknologjisë informative, ne kemi bërë kërkesë për tu pavarësuar pasi jemi institucion i pavarur nga Qeveria. Sa i përket qirasë na u është siguruar objekti në ndërtesën e OSBE-së, qiraja ka të bëjë me zyret që i kemi në komunat e Kosovës. Ka pas të bëjë me pagesën e depos gjatë zgjedhjeve ku janë lënë materialet dhe 2 muaj kemi paguar qira ku ka qenë i vendosur ombudspersoni. Te shërbimet kontraktuese janë 330 mijë euro që kanë të bëjnë me komisionerët në këshilla të vendvotimit për komunën e Rahovecit dhe pjesa e mbetur e komisionarëve për shkak që në muajin e 12 janë mbajtë zgjedhjet dhe na kanë mbetur pagesat e 2010 dhe me përsëritje të zgjedhjeve në disa komuna. Ndërkaq 160 mijë euro na ka kushtuar qendra e numërimit për shkak të rinumërimit të rezultateve.

Pas diskutimeve, Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), asnjë Kundër dhe një Abstenim (Albana Fetoshi), nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011

Kryetarja, theksoi se buxheti i Këshillit, ka ardhur i përmbledhur nuk është detalizuar. Mungojnë të dhënat si është planifikuar dhe si është shpenzuar buxheti sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike.

Edi Shukriu, theksoi se mjete të shumta ndahen për trashëgiminë kulturore për Ministrinë e Kulturës dhe të gjitha ato mjete shfrytëzohen pa u sjellur projekte në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi si e obligon ligji.

Mjetet që na ndahen janë teje të vogla prandaj nuk mund t'i plotësojmë obligimet tona. Ne na mungojnë disa anëtarë të këshillit dhe i kemi shkruar vazhdimisht Kuvendit, për plotësim por skemi pasur asnjë plotësim. Gjithashtu veturat ende nuk i kemi.

Hilmi Demolli, prezantoi shpenzimet e buxhetit, krahasuar me buxhetin e lejuar dhe ndalesat me vendim të qeverisë dhe suficitin e mbetur. Vitin e kaluar kemi pasur mangu 15 mijë euro në dispozicion për qira që është dashur kategoritë tjera të mbesin mangu për të plotësuar pagesën e qirasë.

Latif Gashi, buxheti realisht është shumë i vogël, por nuk kemi detalizime të shpenzimeve. Në raport nuk i kemi të paraqitura planifikimet buxhetore për secilën nënkategori ekonomike, nuk janë paraqitur shpenzimet detale dhe në përqindje. Kemi cekur vetëm për qiranë dhe jo për kategoritë tjera. Do të ishte mirë të ishte më i detalizuar.

Sali Asllanaj, raporti është jo shumë analitik dhe në detaje, por e kuptoj mënyrën e raportimit. Më pëlqen që e keni shkruar ndalesat nga qeveria, pasi që shumë institucione e kanë evidentuar si rishikim i buxhetit, gjë që nuk ka ndodhur. Problemi i mungesës së automjeti është vërtet një histori ne vete. I di problemet e juaja dhe mungesën e ekspertizës së mjaftueshme, dhe mungesën e mjeteve të mjaftueshëm buxhetore për këtë këshill. Kur buxhetet nuk janë shumë të konsoliduar, gjithëmon e pëson trashëgimia kulturore, po shpresoj që gradualisht të ngritet vetëdija edhe do të merremi me keto qeshtje që maksimalisht janë të pariparueshme nuk mundesh kur duash ti bësh.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011.

6. Shqyrtimi Propozim-Vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetarja, theksoi se në pajtim me Ligjin, Komisioni për Përzgjedhje ka propozuar anëtarët për emërim në bordin drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, pasi që kandidatëve aktual iu ka skaduar mandati. Nëse shikohet propozimi shihet se janë respektuar procedurat ligjore në shpalljen e konkursit, mbajtën e intervistave dhe përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet. Ndërkaq nëse shikohen CV-të e kandidatëve të propozuar shifet se i plotësojnë kushtet formalo juridike për të qenë anëtar të bordit, kanë përgatitjet e mjaftueshme universitare dhe përvojën e kërkuar në menaxhimin e mjeteve. Gjithashtu nuk kanë ndonjë pengesë ligjore të paraparë me ligj për të qenë anëtar të bordit. Po ashtu e kemi edhe opinionin e Qeverisë që mbështet kandidatët.

Pas diskutimit, Komisioni një gjashtë vota Për (Safete Hadergjona, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), një Kundër (Jelena Bontic) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozimin e Komisionit për Përzgjedhje, për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, me mandat tre vjeçar, si në vijim:

Ymer Havolli, kryesues
Driton Qehaja, anëtar
Van Driel Leendert Willem, anëtar
Alan Pickering, anëtar
Ruzhdi Morina, anëtar.

7. Të ndryshme.

Komsioni caktoj dy grupet punues, si në vijim:

Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në përbërje: Safete Hadergjonaj (kryesuese), Jelena Bontic, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për taksën ekologjike dhe rrugore të automjeteve, në përbërje: Sali Asllanaj (kryesues), Latif Gashi, Hasime Krasniqi dhe Albana Fetoshi.

Mbledhja përfundoi: 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj